

Dr. Fatbardha Qehaja Osmani është psikologe kognitive dhe Asistente Profesore në Universitetin për Biznes dhe Teknologji (UBT), e specializuar në rolin e funksioneve ekzekutive në lexim, shkrim dhe të nxënit gjuhësor tek fëmijët dhe adoleshentët. Aktualisht ajo udhëheq dy projekte ndërkombëtare kërkimore në bashkëpunim me Universitetin e Padovës dhe Universitetin e Potsdamit, duke eksploruar vlerësimin kognitiv dhe aftësitë e të shkruarit argumentues tek të rinjtë.

Dr. Osmani më parë ka shërbyer si Bashkëpunëtor Postdoktorale në Universitetin e Firences, duke u fokusuar në aftësimin mediatik dhe zhvillimin e aftësive kognitive përmes intervenimeve ndërdisiplinore dhe mjeteve të gamifikuara. Ajo gjithashtu ka menaxhuar një nismë kërkimore shumëkombëshe që trajtonte ngarkesën kognitive në mësimin online dhe atë në praninë fizike në Itali, Mbretërinë e Bashkuar dhe Francë. Si studiuese Fulbright në Haskins Laboratories të Universitetit Yale, ajo fitoi ekspertizë në përdorimin e mjeteve të avancuara matëse në psikologjinë kognitive. Ekspertiza e saj përfshin dizajnimin kërkimor, zhvillimin e instrumenteve vlerësuese, planifikimin e intervenimeve dhe bashkëpunimin me arsimtarë dhe politik-bërës për përmirësimin e rezultateve të nxënies.

Publikimet e saj të fundit sjellin dëshmi të reja mbi zhvillimin e aftësive të leximit në ortografi transparente dhe adaptimin kulturor të mjeteve vlerësuese për fëmijët shqipfolës. Kërkimet e saj janë publikuar në revista të njohura shkencore si *Reading Psychology*, *Psychology in the Schools* dhe *Child Neuropsychology*.